



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr. 2357, datë 27.09.2013

Për

“Shqyrtimin e ankimit administrativ të Altelecom sh.a. për modifikimin e aktit administrativ: Vendim nr. 2337, datë 30.7.2013, “Për përcaktimin e sipërmarrësit Altelecom sh.a me Fuqi të Ndjeshme ne treg dhe vendosjen e masave rregulluese në lidhje me statusin FNT në tregjet e pakicës si dhe në tregun e akses/origjinimit dhe tranzitimit të thirrjeve kombëtare””.

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Znj. Alketa	Mukavelati	Kryetare
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Z. Benon	Paloka	Anëtar
4. Znj. Elkeda	Domi	Anëtare
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtare

dhe sekretare Znj. Mirela Xhelaj, në mbledhjen e datës 27.09.2013, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar me ligjin nr. 102/2012, datë 24.10.2012 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”), ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brendshme të AKEP-it, shqyrtoi çështjen me objekt:

Shqyrtimi i ankimit administrativ të Altelecom sh.a. për modifikimin e aktit administrativ: Vendim nr. 2337, datë 30.7.2013, “Për përcaktimin e sipërmarrësit Altelecom sh.a me Fuqi të Ndjeshme ne treg dhe vendosjen e masave rregulluese në lidhje me statusin FNT në tregjet e pakicës si dhe në tregun e akses/origjinimit dhe tranzitimit të thirrjeve kombëtare”.

BAZA LIGJORE:

1. Neni 8, neni 31 e në vijim, nenit 52, pika 1 e nenit 114, pika 1 e nenit 115, nenet 107 dhe 120/1 të Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008, "*Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë*" i ndryshuar (**Ligji nr. 9918**);
2. Ligji nr. 8485, datë 12.05.1999, "*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*" (K.Pr.A);
3. "*Rregullore për analizën e tregut*", miratuar me vendimin nr. 747, datë 17.07.2009, te Keshillit Drejtues të AKEP (Rregullorja).
4. Pika 17, e nenit 21 të "*Rregullores së Brendshme të AKEP*" (**Rregullorja e Brendshme**), miratuar me Vendim nr. 170, datë 24.04.2004 të Këshillit Drejtues të AKEP, e ndryshuar.

K Ë SHILLI DREJTUES:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

1. Shkresa e Albtelecom sh.a. me nr. 5254Prot., datë 2.9.2013 (*nr. 1484Prot. i AKEP, datë 2.9.2013*), me anë të të cilës ka paraqitur kërkesë ankimore për modifikimin e aktit administrativ: Vendim nr. 2337, datë 30.7.2013, "*Për përcaktimin e sipërmarrësit Albtelecom sh.a me Fuqi të Ndjeshme në treg dhe vendosjen e masave rregulluese në lidhje me statusin FNT në tregjet e pakicës si dhe në tregun e akses/origjinimit dhe tranzitimit të thirrjeve kombëtare*".
2. Vendim Nr. 2336 date 30.07.2013, Për "*Miratimin e Dokumentit: Analizë e tregut telefonisë fikse: tregjet me pakicë dhe tregjet me shumicë të terminimit, tranzitimit dhe origjinimit – Dokumenti Perfundimtar*",
3. Vendim nr. 2337, datë 30.7.2013, "*Për përcaktimin e sipërmarrësit Albtelecom sh.a me Fuqi të Ndjeshme në treg dhe vendosjen e masave rregulluese në lidhje me statusin FNT në tregjet e pakicës si dhe në tregun e akses/origjinimit dhe tranzitimit të thirrjeve kombëtare*"
4. Relacion shpjegues mbi Projekt-Vendimin (**Relacioni**);
si dhe duke i'u referuar diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N :

- 1) Albtelecom sh.a. me anë të shkresës nr. 5254Prot., datë 2.9.2013 (*nr. 1484Prot. i AKEP, datë 2.9.2013*), i drejtohet AKEP me kërkesë ankimore brenda afatit të përcaktuar në nenin 140 të Kodit Procedurave Administrative në lidhje me Vendimin e miratuar nga AKEP nr. 2337, datë 30.7.2013, për "*Përcaktimin e sipërmarrësit Albtelecom sh.a me Fuqi të Ndjeshme në treg dhe vendosjen e masave rregulluese*", me qëllim ndryshimin/modifikimin e vendimit të AKEP për revokimin plotësisht të

statusit FNT në tregjet e pakices, akses/origjinimit dhe tranzitimit kombëtar si dhe për ndryshimin e nivelit të tarifave të interkoneksionit të përcaktuara me këtë vendim.

2) Albtelecom, në lidhje me kërkesën ankimore për heqjen e statusit FNT për tregjet me pakicë dhe tregjet me shumicë të tranzitimit kombëtar dhe akses/origjinimit argumenton se:

- Shpallja me FNT në tregun e aksesit dhe thirrjeve telefonike me pakicë e vendos Albtelecom në pozita diskriminuese në raport me operatorët celularë dominante pasi të njejtët kritere të përdorur për të përcaktuar Albtelecom me FNT në tregun e pakicës, si: pjesët e tregut të numrit të pajtimtarëve dhe për të ardhurat, si dhe dinamika e tyre, do të vlenin për të vlerësuar edhe pozitën me FNT të operatorëve celularë në këtë treg.
- Albtelecom vlerëson se pavarësisht pjesëve të tregut në përqindje të Albtelecom në raport me Operatorët Alternativë, dominanca reale e Albtelecom është e dobësuar në raport me tregun agregat të komunikimeve elektronike, ku pjesa fikse përbën një peshë të vogël krahasuar me peshën që zë tregu i telefonisë së lëvizshme (*vecori dalluese e tregut të komunikimeve elektronike në Shqipëri*).
- Tregu i telefonisë fikse në vend karakterizohet nga një numër i madh operatorësh konkurrente (*77 Operatorë Alternativë aktivë, plus AMC Fiks*).
- Operatorët konkurrentë mund të rrisin pjesën e tregut nëpërmjet detyrimeve të vendosura të zgjedhjes dhe parazgjedhjes së bartësit, portabilitetit të numrit, apo LLU,
- Pavarësisht përqindjes së pjesës së tregut në tregjet me pakicë të aksesit dhe thirrjeve telefonike nga vendndodhje fikse, Albtelecom nuk mund të vendosë cmime në mënyrë të pavarur nga konkurrentët e tjerë.
- Albtelecom vlerëson se hedhja në treg e një larmie të paketave të tarifave sipas nevojave të përdoruesve, si dhe ulja e cmimeve në këto paketa dëshmon se në tregun përkatës ekziston presion konkurrues,
- Abontët e Albtelecom mund të zgjedhin të zëvendësojnë thirrjet jo vetëm ndërmjet operatorëve të tjerë të rrjetit Fiks, por dhe me thirrje celulare sa kohë që tarifën e aplikuar nga operatorët celularë dominante paraqiten të krahasueshme jo vetëm me tarifën e thirrjeve Kombëtare të Albtelecom por edhe me tarifën e thirrjeve lokale.
- Cmimet me pakicë të thirrjeve telefonike nga vendndodhje fikse, kushtëzohen nga cmimet me shumicë, të cilat vijojnë të jenë nën rregjim rregullimi (*përkundrejt cmimeve me pakicë të thirrjeve telefonike celulare që aktualisht nuk kushtëzohen nga cmimet me shumicë nën rregjim rregullimi*).
- Albtelecom vëren se nuk ekziston asnjë pengesë juridike apo strukturore për hyrjen në tregun me shumicë të shërbimeve tranzite në rrjetet telefonike publike fikse të cilat do prej operatorëve, disa prej të cilëve jo vetëm kanë një infrastrukturë të ndërtuar por edhe vazhdojnë të investojnë në zgjerimin e saj.
- Ekziston një ambient konkurrues në tregun kombëtar të tranzitimit dhe të njëjtat rrethana që diktuan AKEP të konsiderojë heqjen e detyrimeve për tranzitimin e thirrjeve ndërkombëtare;

- Në simetri edhe me situatën e detyrimeve ndaj operatorëve të mëdhenj celulare në treg, Albtelecom konsideron që nuk përmbush kriteret për FNT në origjinimin e thirrjeve;
- 3) Albtelecom në lidhje me kërkesën ankimore për nivelin e tarifave dhe referimin e tyre në rezultatet e modelit të kostos së depozituar nga Albtelecom argumenton se:
- Albtelecom, në zbatim të pikës 1, neni 59 të ligjit 9918, ka depozituar në AKEP dokumentin "*Top doën cost model of Albtelecom netëork*", ku ka përlloritur kostot për vitin 2011, në bazë të një modeli për të zbatuar rekomandimet e KE dhe ERG, duke provuar se tarifave të shërbimeve të ofruara prej tij janë rrjedhojë e kostove eficiente, që mundësojnë një normë të arsyeshme fitimi;
 - Albtelecom nuk disponon një vendim apo qëndrim të AKEP, të nxjerre në bazë të procedurave të rregullta që të përmbushë detyrimin sipas pikës 5 të nenit 59 të ligjit 9918. Nje shprehje e përgjithshme e cituar në dokumentin e analizës, "*se të dhënat e relatuara nuk janë bindëse për të vërtetuar se modeli dhe rezultatet e modelit të paraqitur nga Albtelecom, paraqesin kostot eficiente të ofrimit të shërbimeve të Albtelecom*", nuk mund të jetë arsye i mjaftueshëm për një vendimmarrje të rëndësishme për biznesin e Albtelecom;
 - Albtelecom ka kërkuar që me përfundimin e migrimit të rrjetit në NGN/NGA të ketë rikonfigurim të pikave dhe marrëdhënieve të interkoneksionit (*shkresë e dates 10.04. 2013*);
 - AKEP në dokumentin e nxjerrë në konsultim publik ka propozuar ndryshime thelbësore në planin e numeracionit dhe, lidhur me këtë, edhe rikonfigurim të segmenteve të terminimit, (dhe tranzitimit/origjinimit), si dhe të planeve tarifore përkatëse të Albtelecom.

4) Në përfundim të kërkesës ankimore, Albtelecom i kërkon AKEP:

1. Ndryshimin/modifikimin e pikës 1 të vendimit nr. 2337 si më poshtë:

Bazuar në dokumentin "*Analizë e tregut të telefonisë fikse: tregjet me pakicë dhe tregjet me shumicë të terminimit, tranzitimit dhe origjinimit – Dokumenti përfundimtar* – ", miratuar me VKD nr. 2336 datë 30.7.2013.

1.1. Të përcaktojë sipërmarrësin Albtelecom sipërmarrës me FNT në tregun përkatës:

- Tregu me shumicë i terminimit të thirrjeve në rrjetin publik telefonik të Albtelecom të ofruara nga vendndhje fikse.

1.2. Të heqë statusin me FNT të Albtelecom në tregjet përkatëse si më poshtë:

- Tregu me pakicë i aksesit në rrjet publik telefonik nga vendndodhje fikse;
- Tregu me pakicë i thirrjeve telefonike të vlefshme për publikun nga vendndodhje fikse;
- Tregu me shumicë i origjinimit të thirrjeve në rrjetin telefonik publik të ofruar nga vendndodhje fikse;
- Tregu me shumicë i shërbimeve tranzite në rrjetet telefonike publike fikse;

2. Shfuqizimin e pikës 2 të Vendimit nr. 2337.

3. Ndryshimin/modifikimin e pikes 3.5, iii) si më poshtë:

3.1. Vlerat maksimale të tarifave të terminimit në rrjetin e Albtelecom të zbatohen në vlerat ekzistuese sipas vendimit nr. 1348, datë 26.7.2010, deri në një vendimmarrje tjetër të AKEP.

3.2. Vendimi i AKEP për vlerat e tarifave të terminimit në rrjetin e Albtelecom të përkojë me përfundimin e procesit të auditimit të kostove të Albtelecom (mbështetur në të dhënat e dokumentit të AETHA, apo një metodologjie tjetër, të përzgjedhur nga AKEP); duke nyjzuar edhe efektet që mundëson përfundimi i migrimit të rrjetit në NGN/NGA, si dhe ato të pritshme nga zbatimi i planit të ri të numeracionit.

4. Ndryshimin/modifikimin e pikës 6.1 të Vendimit nr. 2337 si më poshtë:

Detyrimet e sipërmarrësit Albtelecom për tregjet me pakicë të shërbimeve të aksesit nga vendndodhje fikse si dhe të shërbimeve për thirrje telefonike përcaktuar edhe me Vendimin nr. 1348, datë 26.7.2013 të Këshillit Drejtues të AKEP, hiqen.

5. Shtimin pikës 6.2/1 si më poshtë:

Detyrimet e sipërmarrësit Albtelecom për tregun me shumicë të akses/origjinimit (Tregu nr. 2 i Rregullores) dhe tregu me shumicë i tranzitimit kombëtar në rrjetet fikse, përcaktuar me VKD nr. 1348, datë 26.7.2010, hiqen

6. Shtimin pikës 6.2/2 si më poshtë:

Heqja e detyrimeve të cituara më lart bëhet efektive 6 muaj nga marrja e vendimit.

5) AKEP pasi ka shqyrtuar sa më lart parashtron Albtelecom arsyeton se:

- a. Argumentat e dhëna nga Albtelecom për heqjen e fuqisë së ndjeshme të tij në tregjet me pakicë të telefonisë fikse (aksesi dhe thirrjet nga vendndodhjet fikse), dhe në tregjet me shumicë të tranzitimit dhe origjinimit të thirrjeve, nuk janë të plota për të hequr statusin e FNT në këto tregje pasi:
- i. AKEP ka argumentuar në dokumentin final të analizës së tregut të telefonisë fikse se aksesit dhe thirrjet nga rrjetet celulare, megjithëse ushtrojnë presion konkurrues ndaj aksesit/thirrjeve nga vendndodhje fikse, nuk konsiderohen ende të jenë pjesë e tregjeve përkatës të aksesit/thirrjeve nga vendndodhje fikse. Në këtë mënyrë faktorët e marrë në konsideratë për FNT të Albtelecom nuk mund të aplikohen edhe për operatorët celularë, për sa kohë këto shërbime nuk konsiderohen pjesë e tregjeve përkatës të njëjtë. Pësia e vogël që zënë shërbime të caktuara në raport me të gjithë tregun e komunikimeve elektronike nuk përbën argument se këto shërbime nuk duhen analizuar për FNT apo që operatorët që i ofrojnë këto shërbime nuk mund të përcaktohen me FNT për këto shërbime, në rast të plotësimit të kriterëve përkatës. Pasha që zë telefonia fikse në raport me të gjithë tregun e komunikimeve elektronike si dhe numri i madh i operatorëve fiks nuk përbëjnë argument për mos-shpallje me FNT të Albtelecom, pasi tregu përkatës nuk është i gjithë sektori i komunikimeve elektronike dhe pjesa e tregut e Albtelecom për tregjet përkatës me pakicë të marrë në shqyrtim është minimalisht 70% duke arritur edhe mbi 90%, megjithë numrin e madh të konkurrentëve. AKEP ka marrë në konsideratë edhe faktorët e tjerë të përmendur nga Albtelecom për zvogëlimin e dominancës së tij në tregjet me pakicë, por AKEP ka arritur në përfundimin se këta faktorë zvogëlojnë dominancën e Albtelecom por nuk pritet që ta eliminojnë atë, apo që tregu i telefonisë fikse të tentojë drejt konkurrencës efektive.
 - b. Në lidhje me argumentet e dhëna për heqjen e FNT në tregun me shumicë të tranzitimit të thirrjeve, AKEP gjykon se pavarësisht shtimit të operatorëve dhe infrastrukturës së tyre për ofrim të tranzitimit të thirrjeve, Albtelecom ka avantazhin e prezencës më të madhe në treg dhe interkonektimit direkt me shumicën e operatorëve aktivë fiks (rreth 60) dhe katër operatorët celularë në Shqipëri. Disa operatorë mund të kryejnë tranzitim drejt Albtelecom nëpërmjet operatorëve të rinj tranzitues, por përsëri shumica e operatorëve kanë nevojë për tranzitimin e thirrjeve drejt operatorëve të tjerë, të cilët nuk kanë mundësi të tjera interkonektimi direkt me shumicën e operatorëve të tjerë.
 - c. Në lidhje me argumentet e dhëna për heqjen e FNT në tregun me shumicë të tranzitimit të thirrjeve, AKEP gjykon se disa masa të implementuara si Z(P)B nuk do të mund të vendoseshin më nëse hiqej FNT te Albtelecom. Ndërkohë faktorët e marrë në konsideratë në tregun e telefonisë celulare, për heqjen e fuqisë së ndjeshme për origjinimin e thirrjeve ndaj dy operatorëve të tjerë, kishin lidhje me rritjen e konkurrencës në tregun me pakicë dhe se të katër operatorët celularë në treg kanë mbulim kombëtar dhe aftësi konkurruese më të madhe se të gjithë operatorët alternativë fiks, përshirë AMC me AMC fiks.

- d. Në lidhje me masat rregulluese në tregun me pakicë, AKEP ka qenë proporcional duke mos vendosur nën rregullim tarifave me pakicë të telefonisë fikse. Për sa i përket peridhës së njoftimit të tarifave të reja, AKEP në versionin final të analizës si dhe në vendimin për FNT, e zvogëloi periudhën nga 2 muaj në 1 muaj, dhe kjo periudhë është e ndryshme nga operatorët e tjerë që nuk janë me FNT në tregjet me pakicë, me qëllim parandalimin e aplikimit të tarifave antikonkurruese nga operatori me FNT. Ky përcaktim nuk bie në kundërshtim me Rregulloren e publikimit të tarifave pasi Rregullorja përcakton se në rastet e FNT, njoftimi I tarifave të reja kryhet sipas vendimit përkatës të AKEP për FNT.
- e. Në lidhje me nivelin e tarifave të interkoneksionit për t'u aplikuar nga Albtelecom dhe çështjes së kostove të përlogarituar nga Albtelecom, AKEP ka sqaruar në dokumentin e analizës se:
- AKEP me Urdhërin nr. 908, datë 16.11.2012, ngriti një Grup Pune me ekspertë të AKEP për "Shqyrtimin e dokumentit të sipërmarrësit Albtelecom sh.a. mbi kostot e shërbimeve". GP ka shqyrtuar dokumentacionin e paraqitur nga Albtelecom, ka kërkuar informacione dhe dokumente shtesë si dhe ka zhvilluar një takim me Albtelecom dhe konsulentin e Albtelecom më datë 11.02.2013. Për verifikimin e kostove të paraqitura nga Albtelecom, GP i është referuar rekomandimeve të KE, ERG/IRG dhe BEREC dhe praktikave më të mira për AS/CA, apo më specifikisht për kostot TD LRIC të cilat janë përgatitur nga Albtelecom. GP, gjykoi se sqarimet e dhëna në dokumentacion si dhe në takim dhe në informacionin shtesë të dërguar nga konsulenti i Albtelecom, nuk janë bindëse për të vërtetuar se modeli dhe rezultatet e modelit të paraqitur nga Albtelecom, paraqesin kostot eficiente të ofrimit të shërbimeve të Albtelecom.

Grupi i punës i ka shprehur Albtelecom dhe konsulentit të tij, komentet në lidhje me rezultatet dhe problemet e tyre.

AKEP me VKD nr. 2336, datë 30.07.2013, ka miratuar dokumentin e Analizës së tregut, përfshirë qëndrimin e tij në lidhje me kostot e depozituara nga Albtelecom. Gjithashtu vlen të theksohet se kërkesa e AKEP për përlogaritjen e kostove nga Albtelecom duke u bazuar në strukturën e re të rrjetit Albtelecom nuk është zbatuar nga Albtelecom, pasi modeli është ndërtuar bazuar në situatën në vitin 2011 dhe rrjetin PSTN të Albtelecom, ndërsa rrjeti NGN/NGA është dhënë si një opsion shtesë i modelit bazuar në supozime të thjeshtëzuara.

Ndërkohë vlerat e tarifave të interkoneksionit të miratuara në versionin final të analizës si dhe me vendimin nr. 2337, janë të arsyeshme duke marrë në konsideratë karakteristikat e vecanta të sektorit në Shqipëri, pasi ato më datë 1 Janar 2014, megjithë reduktimin do jenë 43-130% (63-137%) më të larta se tarifave mesatare në BE më datë 1 Janar 2012 (1 Janar 2013). Pra AKEP nuk ka vendosur thjesht tarifave mestare të BE, por ka marrë në konsideratë vecoritë e Shqipërisë dhe barazimi me mestaren e tarifave të BE, edhe nëse do kryhej do ishte me disa vite sfazim.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Bazuar në pikën 1 të nenit 114, dhe pikën 1 të nenit 115, të ligjit nr. 9918, nenin 146, gërma a) të K.Pr.A, si dhe pikën 17, të nenit 21 të Rregullores së Brendshme,

V E N D O S:

1. Lënien në fuqi të aktit administrativ: Vendim i Këshillit Drejtues nr. 2337, datë 30.7.2013 dhe rrëzimin e ankimit administrativ të Albtelecom sh.a. me nr. 5254Prot., datë 2.9.2013 për modifikimin e aktit administrativ VKD nr. 2337, datë 30.7.2013, *“Për përcaktimin e sipërmarrësit Albtelecom sh.a me Fuqi të Ndjeshme ne treg dhe vendosjen e masave rregulluese në lidhje me statusin FNT në tregjet e pakicës si dhe në tregun e akses/origjinimit dhe tranzitimit të thirrjeve kombëtare”*.
2. Të njoftohet Albtelecom sh.a. për zbatimin e këtij Vendimi;
3. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: www.akep.al

Ky Vendim hyn në fuqi datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R E

Alketa MUKAVELATI

ANËTARË:

1. Alban KARAPICI
2. Benon PALOKA
3. Elkeda DOMI
4. Zamira NURÇE